

J. Y. Parlamentit
Të përgjithshme
10 krahë do të bëjë një
16 nënkomitete
27-12-19
Nr. 822 prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Tiranë, më 26.12.2019

Lënda : Për dërgimin e Listës Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të lejuar për kandidim dhe të Raportit të Arsytuar të Renditjes së tyre, për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në zbatim të pikës 4 të nenit 147/d dhe pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 199, shkronjës “ë” të pikës 2 të nenit 201, nenit 217, të pikës 5 të nenit 229 dhe nenit 239 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, bashkëlidhur dërgohen:

- Vendimi nr. 153 datë 23.12.2019 “Për listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve të lejuar për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019 dhe rishpallur për plotësimin e kandidaturave në datën 09.09.2019”;
- Vendimi nr. 154 datë 23.12.2019 “Për miratimin e raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019 dhe rishpallur për plotësimin e kandidaturave në datën 09.09.2019”;
- Raporti për renditjen e kandidatëve të lejuar, për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019 dhe rishpallur për plotësimin e kandidaturave në datën 09.09.2019;
- Lista Treguese dhe aktet përkatëse (a) të lejimit të kandidimit dhe (b) të vlerësimit e të pikëzimit të kandidaturës për secilin kandidat të lejuar për kandidim, (c) aktet e përfundimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës për kandidatët e tërhequr nga kandidimi, si edhe (ç) aktet e ndalimit të kandidimit për kandidatë që nuk përmbushën kushtet dhe kriteret ligjore të kandidimit.
- Akte të tjera të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në procedurën e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin

KRYETARI
Ardian Dvorani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 153, datë 23.12.2019

**PËR LISTËN PËRFUNDIMTARE TË RENDITJES SË KANDIDATËVE TË LEJUAR
PËR INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË, SHPALLUR NGA KËSHILLI I
EMËRIMEVE NË DREJTËSI NË DATËN 01.03.2019 DHE RISHPALLUR PËR
PLOTËSIMIN E KANDIDATURAVE NË DATËN 09.09.2019**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 147/d dhe pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 199, të shkronjës “ë” të pikës 2 të nenit 201, nenit 217, të pikës 5 të nenit 229 dhe nenit 239 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikave 68, 70 dhe 72 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi dëgjoji relatimin e relatores, znj. Margarita Buhali dhe si e bisedoi çështjen, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve të lejuar për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019 dhe rishpallur për plotësimin e kandidaturave në datën 09.09.2019, si më poshtë :

- | | |
|-----------------------|-----------|
| 1) Artur Metani | 89.6 Pikë |
| 2) Sokol Stojani | 89 Pikë |
| 3) Joana Asimi Sorraj | 82.2 Pikë |
| 4) Eris Hysi | 78.3 Pikë |
| 5) Lindita Troja | 63.4 Pikë |

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 154, datë 23.12.2019

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE TË LEJUAR
PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT TË INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË, SHPALLUR NGA KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI NË
DATËN 01.03.2019 DHE RISHPALLUR PËR PLOTËSIMIN E KANDIDATURAVE
NË DATËN 09.09.2019**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 147/d dhe të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të shkronjës “ë” të pikës 2 të nenit 201 dhe të pikës 5 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikave 71 dhe 72 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit për Renditjen e Kandidatëve të Lejuar për Plotësimin e Vendit Vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019 dhe rishpallur për plotësimin e kandidaturave në datën 09.09.2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

RAPORT

**PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE TË LEJUAR PËR PLOTËSIMIN E VENDIT
VAKANT TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, SHPALLUR NGA
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI NË DATËN 01.03.2019 DHE
RISHPALLUR PËR PLOTËSIMIN E KANDIDATURAVE NË DATËN 09.09.2019**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në përfundim të të gjitha procedurave të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të kandidimit, si edhe të atyre të vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve të lejuar, në zbatim të pikës 4 të nenit 147/d, pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës dhe shkronjës “ë” të pikës 2 të nenit 201 të ligjit nr. 115/2016, së bashku me listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe akteve të nxjerra në këtë procedurë, i paraqet Kuvendit edhe Raportin e arsyetuar për procedurat e ndjekura, arsyet e marrjes së vendimeve për lejimin apo ndalimin e kandidimeve, si edhe veprimeve dhe arsyetimeve të ndjekura për pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të lejuar për këtë vend vakant.

Në pikën 4 të nenit 147/d të Kushtetutës parashikohet se:

“4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga lista e pesë kandidatëve të përzgjedhur dhe renditur mbi bazën e meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas një procedure transparente dhe publike. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej tri të pestave për asnjë prej kandidatëve brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës, kandidati i renditur i pari shpallet i emëruar..”.

Ndërsa në pikën 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, parashikohet se:

“1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati.”.

Në zbatim të këtyre dispozitave kushtetuese, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë që të kryejë:

- *së pari*, procedurën e verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore të kandidimit;
- *së dyti*, në lidhje me kandidatët e lejuar për kandidim, KED kryen vlerësimin e tyre bazuar në kriteret ligjore mbi meritat profesionale, morale dhe administrative të kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë;
- *së treti*, mbi bazën e këtij vlerësimi, KED bën edhe pikëzimin e meritave për secilin kandidat të lejuar për kandidim;



- së katërti, KED përgatit dhe miraton listën përfundimtare të renditjes së të gjithë kandidatëve të lejuar për kandidim.

Në listën përfundimtare të miratuar nga KED, gjenden edhe kandidatët e renditur në pesë vendet e para, ndërmjet të cilëve, sipas pikës 4 të nenit 147/d të Kushtetutës dhe ligjit nr.115/2016, Kuvendi, si organi përkatës i emërtesës, ka të drejtë të zgjedhë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Në rastin konkret lista përfundimtare e kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë përbëhet vetëm nga 5 kandidatë të përzgjedhur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, aq sa është dhe numri minimal kushtetues i kandidatëve të nevojshëm për tu paraqitur para organit të emërtesës sipas Kushtetutës.

Në krye të kësaj liste përfundimtare të miratuar nga KED, gjenden edhe kandidatët e renditur në pesë vendet e para, ndërmjet të cilëve, sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligjit nr.115/2016, Kuvendi, si organi përkatës i emërtesës, ka detyrimin të përzgjedhë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Në pikën 2 të nenit 199 të ligjit të posaçëm me nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", parashikohet se:

"2. Këshilli për Emërimet në Drejtësi i rendit kandidatët për postin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që përmbushin kushtet ligjore të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, në bazë të kriterëve objektive të parashikuara në nenin 240 të këtij ligji."

Në pikën 2, shkronjat "e", "ë" dhe "f" të nenit 201 të këtij ligji, parashikohet se:

"e) Këshilli i Emërimeve në Drejtësi lejon kandidimin e kandidatëve që plotësojnë kushtet formale, si dhe i rendit kandidatët në listë sipas kriterëve të parashikuara në nenin 240 të këtij ligji.

ë) lista e renditjes së kandidatëve të vlefshëm dhe arsyet e përjashtimit të kandidaturave, në qoftë se ndodh, publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe i përcillen Kuvendit brenda tre ditëve;

f) nëse Kuvendi nuk arrin shumicën e kërkuar për asnjë prej kandidatëve brenda tridhjetë ditëve nga paraqitja e propozimeve, kandidati i renditur i pari në listë konsiderohet i emëruar."

Më tej, në pikën 5 të nenit 229 të këtij ligji, parashikohet se:

"5. Në përfundim të procesit të verifikimeve, sipas pikës 4, të këtij neni, Këshilli interviston kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore, bën renditjen e tyre sipas kriterëve të parashikuara në nenin 240, të këtij ligji, dhe harton një raport ku arsyetohet këtë renditje."

Në zbatim të këtyre dispozitave ligjore, kompetencë dhe përgjegjësi e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është edhe hartimi i këtij Raporti në lidhje me procedurën e ndjekur për verifikimin dhe vlerësimin e kandidaturave, si edhe në lidhje me arsyetimin e renditjes së të gjithë kandidatëve të lejuar për kandidim, ku evidentohen edhe ata të renditur në pesë vendet e para mes të cilëve Kuvendi përzgjedh Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Ky Raport bazohet dhe referon në arsyetimet e hollësishme që përmbajnë, për secilin kandidat të lejuar:

- a) vendimi përkatës i lejimit të kandidimit dhe
- b) vendimi përkatës i vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit/es të lejuar për kandidim.



Këshilli vlerëson se arsyetimi në Raport për renditjen e kandidatëve sipas dispozitave ligjore të sipërcituara, duhet të reflektojë hapat dhe mënyrën me të cilën Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka kryer vlerësimin dhe pikëzimin që i ka bërë secilit kandidat lidhur me meritat profesionale, morale dhe organizative, bazuar në kriteret e vlerësimit, peshën dhe rëndësinë e tyre sikurse parashikohen në ligj dhe aktet normative që ka miratuar Këshilli.

Sipas ligjit, jo vetëm vlerësimi individual i secilit kandidat, por edhe renditja e tyre përfundimtare, nuk realizohen nëpërmjet “krahimit” të meritave të kandidatëve përkundrejt njëri-tjetrit. Për rrjedhojë edhe arsyetimi i Raportit lidhur me renditjen e kandidatëve nuk mund të përmbajë konstatime ose opinione të natyrës krahasuese ndërmjet kandidatëve të renditur. Ligji nuk i njeh Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ndonjë kompetencë apo diskrecion të tillë.

Përkundrazi, kompetenca dhe detyrimi i Këshillit është të vlerësojë dhe pikëzojë secilin kandidat individualisht, bazuar në meritat e tij/saj individuale profesionale, morale dhe administrative, nisur nga shqyrtimi dhe analiza objektive dhe profesionale e të dhënave konkrete që rezultojnë nga dokumentacioni dhe intervista përkatëse me kandidatin/en, për secilin kriter vlerësimi të parashikuar në nenet 199, 201 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016, të rregulluar më hollësisht nga vendimi nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, si edhe nga orientimet për vlerësimin dhe pikëzimin që ky Këshill ka miratuar për qëllime të uniformizimit të qëndrimeve të tij dhe të transparencës së këtij procesi vlerësimi e pikëzimi nëpërmjet Metodologjisë përkatëse të miratuar me vendimin nr. 52 datë 21.06.2019.

Prandaj, për secilin kandidat të lejuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka disponuar me vendim të veçantë, duke arsyetuar vlerësimin e tij për secilin kriter ligjor vlerësimi dhe duke i përcaktuar pikëzimin përkatës. Në përfundim të arsyetimit dhe pikëzimit për të gjitha kriteret e vlerësimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka disponuar për vlerësimin në tërësi, duke përcaktuar pikëzimin e kandidatit/es si rezultat i totalit të pikëzimit të caktuar për secilin kriter vlerësimi.

Arsyetimi për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve për secilin kriter ligjor është rezultati i vlerësimit të përbashkët, kolegjal, të anëtarëve të Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Sipas ligjit dhe rregullave më të hollësishme të aktit normativ, vendimi i KED nr.5 datë 21.06.2019, në fazën e bisedimit të vlerësimit të kandidaturës në shqyrtim, secili anëtar i Këshillit arsyeton mendimin e tij dhe deklaron pikëzimin përkatës për secilin kriter vlerësimi. Ndërsa pikëzimi total i kandidaturës e që rezulton edhe në dispozitivin e vendimit të Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, është rezultati aritmetik mesatar i dalë nga veprimi i mbledhjes së totalit të pikëzimit të dhënë nga secili anëtar i Këshillit pjesëtuar me numrin e anëtarëve të Këshillit.

Për rrjedhojë, edhe arsyetimi i vlerësimit të Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për secilin kriter, duke pasur parasysh qëndrimet e secilit prej anëtarëve të Këshillit, njëkohësisht reflekton rezultanten e përbashkët të këtyre qëndrimeve dhe arsyetimeve, të konvertuara në pikëzimin përkatës të përbashkët të kandidatit për secilin kriter. Rast pas rasti, nëse vlerësimi dhe pikëzimi i një apo disa anëtarëve të Këshillit, lidhur me një a më shumë prej kriterëve të vlerësimit, është i kundërt apo dukshëm i ndryshëm nga ai i disa anëtarëve të tjerë të Këshillit, arsyetimi përkatës i ndryshëm i këtyre anëtarëve i bashkëlidhet vendimit kolegjal të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidaturës.

Duke pasur parasysh këto veçanti të procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidaturave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi si organ kolegjal dhe si rezultat i mbledhjes së vlerësimeve individuale të secilit anëtar të tij e që janë jo domosdoshmërisht të njëjta me njëra tjetrën, Këshilli vlerëson se mënyra e duhur e pasqyrimit të vlerësimeve dhe pikëzimit të kandidatëve në këtë Raport të arsyetuar për efekt të renditjes së tyre në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është ajo e referimit në vendimin përkatës të Këshillit për vlerësimin dhe pikëzimin e secilës kandidaturë, vendime që përmbajnë arsyetim të hollësishëm mbi vlerësimin e meritave të kandidatëve dhe pikëzimin e tyre në tërësi dhe për secilin kriter ligjor vlerësimi.

Nisur nga këto veçanti të procedurës së vlerësimit, pasqyrimi në këtë Raport i çfarëdo forme përmbledhjeje të arsyetimit shumë të hollësishëm që përmbajnë vetë vendimet përkatëse të vlerësimit dhe pikëzimit, në vend të lehtësimit të punës së Kuvendit si organi i emërtesës dhe të transparencës publike, do të prodhonte efektin e kundërt.

Ndërkohë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se do të përbënte përsëritje të panevojshme dhe do të vështirësonte kuptimin dhe përmbajtjen e Raportit, nëse arsyetimet e përmbajtura në vendimet përkatëse të verifikimit dhe atyre të vlerësimit të kandidaturave do të përsëriteshin integralisht në tekstin e këtij Raporti.

Nga ana tjetër, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i zgjedhur me short nga Kuvendi në datën 7 Dhjetor 2018, në kushtet kur, Këshillat e mëparshëm nuk kishin përgatitur dhe miratuar rregullat e brendshme dhe aktet e tjera nënligjore normative të deleguara me ligj, është gjendur në pamundësi për të filluar dhe zbatuar menjëherë procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidaturave, përfshirë edhe të atyre për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në të tilla rrethana, përveç masave të tjera të shumta organizative dhe administrative për përgatitjet e domosdoshme në funksion të zbatimit e mbështetjes së procedurave të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidaturave, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka filluar menjëherë edhe veprimtarinë e tij me përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e kuadrit rregullator dhe nënligjor të kërkuar sipas ligjit.

Me vendimin nr. 1, datë 08.02.2019, Këshilli ka miratuar aktin *“Rregullore e brendshme për funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”*.

Me vendimin nr. 2, datë 15.02.2019, Këshilli ka miratuar aktin nënligjor normativ *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*.

Me vendimin nr. 4 datë 11.03.2019, Këshilli ka miratuar aktin nënligjor normativ *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*.

Me vendimin nr. 5, datë 02.04.2019, Këshilli ka miratuar aktin nënligjor normativ *“Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*.

Me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019, Këshilli ka miratuar *Metodologjinë për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve për Renditjen e Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese*.



Me vendimin nr. 52 datë 21.06.2019, Këshilli ka miratuar *Metodologjinë për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve për Renditjen e Kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë*.

Ashtu sikurse përcakton Kushtetuta, ligji nr.115/2016 dhe aktet nënligjore normative të sipërcituara, dërgimi pranë Kuvendit si organi i emërtesës të renditjes së të gjithë kandidatëve të lejuar për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ku gjenden edhe kandidatët e renditur në pesë vendet e para për efekt të zgjedhjes nga ky organ emërtese sipas urdhërimeve të pikës 4 të nenit 147/d Kushtetutës dhe të ligjit, është rrjedhojë e realizimit:

- *së pari*, të procedurës së verifikimit dhe kontrollit të plotësimit të kushteve të kandidimit për secilin kandidat dhe;
- *së dyti*, të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për kandidim, në secilin vend vakant.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i zgjedhur me short nga Kuvendi në datën 07.12.2018, për të ushtruar veprimtarinë dhe kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" gjatë periudhës 01.12.2019 deri në 31.12.2019, duke konstatuar se, përpara fillimit të veprimtarisë së tij, sipas dispozitave ligjore kalimtare, kishin shprehur interesin për kandidim në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vetëm katër kandidatë (*Albana Shtylla, Artur Malaj, Lefteri Lleshi Luzi dhe Marsida Xhaferllari*), njëra prej të cilëve (*Albana Shtylla*) u tërhoq nga kandidimi në datën 14.01.2019; duke vlerësuar që edhe përpara së të fillonin procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave numri i kandidatëve ishte më i vogël sesa numri minimal prej 5 kandidatësh të parashikuara në pikën 4 të nenit 147/d të Kushtetutës; duke vlerësuar që qëllimi dhe afatet e përcaktuar nga dispozitat ligjore kalimtare për të mundësuar përzgjedhjen e shpejtë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kishin përfunduar në vitin 2017, si edhe me qëllimin e krijimit të mundësive për të pasur një numër sa më të madh kandidatësh në funksion të përzgjedhjes së kandidaturave me cilësi të larta profesionale dhe sipas kushteve e kriterëve ligjore të kandidimit për funksionin kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kompetencave që i ngarkojnë nenet 199, 201 dhe 234 pika 4 të ligjit nr. 115/2016, me vendimin nr.3 datë 01.03.2019, vendosi hapjen e procedurës së aplikimit për pozicionin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në përfundim të afatit të shpalljes për hapjen e procedurave të aplikimit, në datën 20.03.2019, rezultoi që për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kanë shprehur interesin për të kandiduar 13 kandidatë:

1. Altin Hazizaj
2. Artur Malaj
3. Artur Metani
4. Elira Kokona
5. Eris Hysi
6. Ferdinand Caka
7. Genci Gjonçaj
8. Genci Ismaili
9. Klodian Rado
10. Lefterie Lleshi (Luzi)
11. Marsida Xhaferllari
12. Mimoza Qinami
13. Suzana Frashëri.



Në zbatim të nenit 147/d dhe 149/d të Kushtetutës, të neneve 199, 201, 229, 235 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short të relatorit për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 shorti për caktimin e relatorit organizohet përmes sistemit të administrimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë. Përrjashtimisht, në qoftë se sistemi elektronik nuk funksionon, shorti mund të kryhet manualisht.

Në zbatim të ligjit, Këshilli ka njoftuar Gjykatën e Lartë për kohën e realizimit të shortit dhe mundësinë e organizimit të tij përmes sistemit elektronik të administrimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Lartë ka njoftuar Këshillin, duke paraqitur edhe një raport teknik me shkrim të sektorit të teknologjisë së informacionit, nëpërmjet të cilit shpjegohet dhe konfirmohet që programi i sistemit elektronik të administrimit të çështjeve të kësaj Gjykate nuk e mundëson realizimin e një procedure shorti lidhur me identitete funksionarësh që nuk janë gjyqtarë apo këshilltarë të kësaj Gjykate dhe për lloje çështjesh që nuk kanë natyrë gjyqësore.

Këshilli, pasi u njoh dhe diskutoi lidhur me pamundësinë teknike të realizimit të shortit në rrugë elektronike, me vendim të ndërmjetëm të mbledhjes së tij të datës 05.04.2019, vendosi të realizojë shortin në formën manuale, me praninë e anëtarëve të Këshillit, Avokates së Popullit dhe përfaqësuesve të subjekteve të ftuar sipas ligjit.

Në vijim, sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, relatore për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj.Margarita Buhali.

Sipas procedurave të parashikuara në ligj dhe në aktet normative të miratuara nga KED, Këshilli ka filluar dhe ndjekur procedurat e verifikimit të përmbushjes së kushteve ligjore për kandidim njëherazi për secilën kandidaturë në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për realizimin e procedurave të verifikimit të kandidaturave, përveç veprimeve verifikuese të kryera nga vetë Këshilli bazuar në informacionin e hollësishëm dhe voluminoz të dërguar nga institucione publike dhe private sipas kërkesave të Këshillit, ushtrimi i kontrolleve të thelluara për pasurinë, integritetin dhe kushtet e tjera ligjore është realizuar



edhe nga disa institucione të tjera, si ILDKPKI, DSIK, agjencitë informative, Ministria e Brendshme, AIDSSH, KLGJ, KLP etj., të cilat, i kanë përcjellë Këshillit raportet, të dhënat dhe gjetjet përkatëse. Në rastin e agjencive informative, për shkak të parashikimeve ligjore, informacioni i klasifikuar dhe i përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, janë dërguar nëpërmjet DSIK bazuar në kërkesën e KED për ndihmë administrative në këtë proces ligjor verifikimi. Informacioni i hollësishëm për korrespondencën dhe përgjigjet e dërguara nga të gjitha institucionet publike dhe subjektet private parashtrihen konkretisht dhe në detaje në vendimet e KED-së në procedurën e verifikimit të secilit kandidat të lejuar ose të ndaluar apo të tërhequr nga kandidimi

Gjithashtu, në datën 05.04.2019, me anë të një njoftimi publik, i cili është përcjellë edhe nga të gjitha mjetet e masmedias, Këshilli i është drejtuar publikisht me një thirrje-kërkesë të gjitha institucioneve publike, organizatave dhe shoqërisë civile, MEDIA-s dhe publikut, për të përcjellë opinione, të dhëna dhe informacione në lidhje me kandidatët.

Këshilli publikisht ka mbajtur qëndrimin se ky njoftim nuk ishte thjesht përmbushje të një detyrimi ligjor kundrejt publikut. KED synon të garantojë një proces të rregullt ligjor, transparent, me integritet dhe të besueshëm dhe është shprehur tërësisht i angazhuar për të vlerësuar dhe mirëpritur kontributin e secilit prej tyre, duke marrë përsipër shqyrtimin me vëmendje të veçantë, objektivitet dhe profesionalizëm, në funksion të verifikimit të gjithanshëm dhe sa më të thelluar të integritetit të kandidatëve, si dhe për të mundësuar për zgjedhjen mes tyre, të kandidatëve bazuar në meritat profesionale dhe morale. Gjithsesi, konstatohet se pothuajse nuk ka pasur opinione dhe informacione të përcjella prej tyre pranë Këshillit.

Nga ana tjetër, në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore normative, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka shqyrtuar të gjitha raportet dhe informacionet e dërguara nga institucionet publike dhe subjektet private, sikurse edhe ato të depozituara pranë këtij Këshilli nga vetë kandidatët në kohën e aplikimit për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo të sjella në vijim pranë Këshillit prej tyre, kryesisht ose në përgjigje të kërkesave të Këshillit.

Në përfundim të procedurave të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka shqyrtuar në mbledhjet e tij gjetjet në procedurat e verifikimit edhe për të gjithë kandidatët që kanë shprehur interesin për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2018.

Në lidhje me kandidatët që kanë shprehur interes për plotësimin e këtij vendi vakant, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka disponuar, sipas rastit, përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës, ndalimin e kandidimit ose lejimin e kandidimit. Ndërkohë që, kandidati *Ferdinad Caka* është tërhequr nga kandidimi në datën 26.03.2019, pra përpara se Këshilli të fillonte procedurat e verifikimit të kandidaturave dhe të dispononte lidhur me to.

Më konkretisht, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës, për shkak të tërheqjes nga kandidimi, për kandidatët si më poshtë:

1. Lefteri Lleshi (Luzi) - vendimi nr. 17, datë 10.05.2019;
2. Suzana Frashëri - vendimi nr. 22, datë 10.05.2019;
3. Genci Ismaili - vendimi nr. 28, datë 14.05.2019;
4. Elira Kokona - vendimi nr. 48, datë 05.06.2019;



Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur ndalimin e kandidimit, për kandidatët si më poshtë :

1. Altin Hazizaj - vendimi nr. 53, datë 24.07.2019;
2. Mimoza Qinami - vendimi nr. 77, datë 24.07.2019;
3. Genci Gjonçaj - vendimi nr. 99, datë 30.07.2019;
4. Klodian Rado - vendimi nr.107, datë 02.08.2019;

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur lejimin e kandidimit, për kandidatët si më poshtë :

1. Artur Malaj - vendimi nr.69, datë 24.07.2019 ;
2. Artur Metani - vendimi nr.100, datë 30.07.2019;
3. Eris Hysi - vendimi nr.106, datë 30.07.2019;
4. Marsida Xhaferllari - vendimi nr.110, datë 06.08.2019;

Të gjitha këto vendime janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, pjesa e posaçme për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Ndërkohë, kopje e këtyre vendimeve i bashkëlidhen këtij Raporti.

Në kushtet kur në përfundim të procedurave të verifikimit të kandidaturave për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rezultuan vetëm katër kandidatë të lejuar, ndërkohë që në pikën 4 të nenit 147/d të Kushtetutës parashikohet se Kuvendi për zgjedh këtë funksionar kushtetues nga lista prej pesë kandidatësh të lejuar të renditur nga KED, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shtroi për diskutim mënyrën e procedimit të mëtejshëm dhe me qëllimin e krijimit të mundësive për të pasur kandidatë të tjerë për plotësimin e këtij parashikimi kushtetues, me vendimin nr.121 datë 09.09.2019 vendosi pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e procedurës së thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e këtij vendi vakant.

Në datën 20.09.2019, në përfundim të afatit të shpalljes së thirrjes për paraqitjen e kandidaturave të tjera, rezultoi që paraqitën kërkesën për kandidim së bashku me dokumentacionin përkatës pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi kandidatët si më poshtë:

1. Klodian Rado
2. Joana Asimi Sorraj
3. Lindita Troja
4. Sokol Stojani

Menjëherë pas paraqitjes së këtyre kandidaturave, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka zhvilluar të gjitha procedurat e parashikuara në ligj për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të kandidimit të tyre për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në të njëjtën periudhë, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me vendimin nr.27, datë 24.10.2019 ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 62, datë 03.08.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artur Malaj, i cili është njëri nga kandidatët për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Gjithashtu, një tjetër kandidate për këtë vend vakant, znj. Marsida Xhaferllari, me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 11350 datë 13.11.2019, është emëruar gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese.



Në përfundim të procedurave të verifikimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës, për shkak të tërheqjes nga kandidimi, për kandidatët si më poshtë:

1. Klodian Rado - vendimi nr.143, datë 02.12.2019;
2. Marsida Xhaferllari - vendimi nr.144, datë 02.12.2019;

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr.69 dt. 24.07.2019 të marr prej tij dhe ndalimin e kandidimit, për kandidatin si më poshtë :

1. Artur Malaj - vendimi nr.142, datë 02.12.2019;

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur lejimin e kandidimit, për kandidatët si më poshtë :

1. Sokol Stojani - vendimi nr.139, datë 02.12.2019;
2. Lindita Troja - vendimi nr.140, datë 02.12.2019;
3. Joana Asimi Sorraj - vendimi nr.141, datë 02.12.2019;

Të gjitha këto vendime janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, pjesa e posaçme për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Ndërkohë, kopje e këtyre vendimeve i bashkëlidhen këtij Raporti.

Për rrjedhojë, sikurse parashtrohet më sipër, në përfundim të procedurave të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të të gjithë kandidatëve për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur lejimin e kandidimit, për kandidatët si më poshtë :

1. Artur Metani
2. Eris Hysi
3. Joana Asimi Sorraj
4. Lindita Troja
5. Sokol Stojani

Vendimet përkatëse të KED për lejimin e kandidimit, për secilin nga të pesë kandidatët e lejuar, përmbajnë përshkrimin e të dhënave dhe gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidaturës, si edhe analizë e arsytim të hollësishëm mbi procedurat e ndjekura dhe për plotësimin e secilit kusht dhe kriter ligjor kandidimi që parashikohen nga Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016.

Në përfundim të procedurave të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të të gjithë kandidatëve që janë kandiduar për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi realizoi edhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve të lejuar për kandidim.

Për këtë qëllim, me vendimet nr.145, nr.146 dhe nr. 147 të datës 11.12.2019, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shpalli fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar kandidim në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, miratoi ekspertin për vlerësimin e njohurive në gjuhën angleze, kalendarin e intervistave me kandidatët e lejuar, si edhe realizoi intervistat me të pesë kandidatët e lejuar.



Kompetenca e KED për vlerësimin e kandidatëve të lejuar për kandidim, si edhe ndonjë element i kriterëve të vlerësimit përcaktohen drejtpërdrejt nga nenet 147/d dhe 149/d të Kushtetutës. Ndërkohë, kriteret e tjera ligjore të vlerësimit të kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë përcaktohen veçanërisht në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016.

Nga ana tjetër, Kushtetuta dhe ligji nr.115/2016, parashikojnë detyrën e KED për të realizuar renditjen e kandidatëve që janë verifikuar paraprakisht për plotësimin e kushteve ligjore të kandidimit, si edhe vlerësimin nëpërmjet pikëzimit si një mënyrë e përzgjedhur për të reflektuar arsyetimin e KED lidhur me renditjen e kandidatëve dhe për ta materializuar këtë vlerësim në renditje nëpërmjet këtij elementi objektiv.

Pikëzimi, i cili është rrjedhojë e arsyetimit për vlerësimin e meritave të kandidatit për secilin kriter ligjor, parashikohet shprehimisht në pikën 2 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016. Gjithashtu, kjo dispozitë si edhe pika 6 e nenit 240 të këtij ligji i delegojnë Këshillit detyrimin për të përgatitur dhe miratuar rregulla të hollësishme jo vetëm për procedurën e vlerësimit të kandidaturave, por edhe për rregullimin më të hollësishëm të kriterëve ligjore të vlerësimit, duke pasur parasysh rëndësinë dhe peshën specifike të tyre, shpërndarjen e pikëve dhe caktimin e pikëzimit maksimal për secilin kriter dhe në tërësi, përcaktimin e mënyrave, llojeve dhe burimeve dokumentare e bisedimore të vlerësimit.

Këto rregulla të hollësishme parashikohen në aktin nënligjor me karakter normativ të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vendimi nr.5 datë 02.04.2019 *“Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*. Sipas natyrës, rëndësisë dhe peshës specifike në vlerësim, kriteret ligjore ndahen në kategori dhe secila kategori zbërthehet në elementë më të hollësishëm vlerësues. Edhe shpërndarja e pikëve parashikohet sipas llojit dhe rëndësisë së secilës kategori, sikurse edhe sipas llojit e rëndësisë së atyre të elementëve që sipas ligjit e përbëjnë vlerësimin e kandidaturës për atë kategori vlerësimi.

Përtej këtij detyrimi, KED vlerësoi që, për qëllime të uniformizimit të qëndrimeve të tij dhe të transparencës së këtij procesi vlerësimi e pikëzimi, të përgatisë, miratojë dhe bëjë publike edhe një dokument tjetër rregullator të brendshëm mbi Metodologjinë që ndjek për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve, i cili është miratuar me vendimin e KED nr. 51 datë 21.06.2019.

Sipas kriterëve të vlerësimit dhe procedurave të sipërcituara të parashikuara në ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e zbatim të tyre nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për qëllimet e vlerësimit dhe pikëzimit të secilës kandidaturë të lejuar, janë administruar dhe shqyrtuar dokumentacioni i paraqitur apo i përzgjedhur nga vetë kandidatët, si edhe dokumente e të dhëna të tjera të siguruara nga institucione publike e private, të kërkuara kryesisht nga ky Këshill.

Gjithashtu, në zbatim të pikës 5 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, në mbledhje të organizuara për këtë qëllim, Këshilli ka realizuar intervistë me secilin kandidat të lejuar:

- *së pari* për tu njohur me motivimin e kandidimit, pikëpamjet dhe vizionin e kandidatit/es lidhur me veprimtarinë dhe sfidat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- *së dyti*, për të verifikuar cilësitë e kandidaturës në lidhje me elementë të tjerë të formimit të përgjithshëm profesional e qytetar etj.;
- *së treti*, për të vlerësuar nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja, me praninë e ekspertit të përzgjedhur nga radhët e trupës akademike të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, duke zhvilluar për këtë qëllim, në një pjesë të



intervistës, edhe bisedën mes ekspertit dhe kandidatit/es, në gjuhën e huaj të përzgjedhur nga vetë kandidati, duke e mbajtur parasysh mendimin me shkrim të ekspertit në vlerësimin e këtij kriteri ligjor.

Mbi këto baza të dhënash dhe veprimesh vlerësimi, për secilin kandidat, Këshilli ka vënë në bisedim shkallën e vlerësimit dhe masën e pikëzimit të secilit kriter ligjor vlerësimi. Çdo anëtar i Këshillit që ka marrë pjesë në vendimmarrjen për lejimin e kandidimit dhe në intervistën me kandidatët e lejuar, duke filluar nga relatori i vendit vakant, për secilin kriter ligjor vlerësimi, ka parashtruar argumentet dhe arsyet ku mbështet shkallën e tij të vlerësimit dhe për të cilat ka çmuar ti caktojë pikët përkatëse kandidatit/es.

Pas dhënies së mendimit për shkallën e vlerësimit dhe masën përkatëse të pikëve për secilin kriter ligjor vlerësimi nga secili anëtar i Këshillit, rezultati përfundimtar i vlerësimit, për efekt të pikëzimit dhe renditjes së kandidatit, është përcaktuar nga shumatorja e pikëve të dhëna për secilin kriter ligjor vlerësimi nga çdo anëtar i Këshillit, i plotëpjestuar me numrin e anëtarëve të tij që kanë marrë pjesë në vlerësim.

Bazuar në diskutimin dhe mendimet e dhëna nga anëtarët e Këshillit lidhur me shkallën e vlerësimit të kandidatit/es për secilin kriter ligjor kandidimi, anëtari relator ka përgatitur vendimin e KED që përmban përshkrimin e hollësishëm të procedurës së ndjekur, si edhe arsyetimin e përbashkët të anëtarëve mbi shkallën e vlerësimit dhe të pikëzimit përkatës të meritave të kandidatit/es për secilin kriter ligjor vlerësimi.

Vendimet e KED për vlerësimin dhe pikëzimin e secilit prej pesë kandidatëve të lejuar, Tabela Përmbledhëse të Pikëzimit si edhe Dokumentet që përmbajnë vlerësimin në pikë nga secili anëtar i Këshillit, si edhe dokumentet që përmbajnë vlerësimet në pikë nga secili anëtar i Këshillit, janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, pjesa e posaçme për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Ndërkohë, kopje të këtyre vendimeve, Tabelës Përmbledhëse të Pikëzimit, si edhe të Dokumenteve që përmbajnë vlerësimet në pikë nga secili anëtar i Këshillit, i bashkëlidhen këtij Raporti.

Mbështetur në këtë procedurë vlerësimi dhe në vendimet e arsyetuara të vlerësimit e të pikëzimit të secilit kandidat, në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës, të shkronjës “ë” të pikës 2 të nenit 201 dhe të pikës 5 të nenit 229 të ligjit nr.115/2016, relatori i vendit vakant ka përgatitur dhe paraqitur për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit listën përfundimtare të renditjes së të gjithë kandidatëve të lejuar për kandidim në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në mbledhjen e tij, Këshilli ka verifikuar saktësinë aritmetike të pikëzimit për secilin kriter dhe të pikëzimit në total për secilin kandidat sipas vendimeve përkatëse të vlerësimit.

Prandaj, me vendimin nr. 153 datë 23.12.2019, pas verifikimit të saktësisë aritmetike të pikëzimit total për secilin kandidat sipas vendimeve përkatëse të vlerësimit dhe pikëzimit. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka miratuar listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve të lejuar për kandidim në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si më poshtë:

1)	Artur Metani	89.6 Pikë
2)	Sokol Stojani	89 Pikë
3)	Joana Asimi Sorraj	82.2 Pikë
4)	Eris Hysi	78.3 Pikë
5)	Lindita Troja	63.4 Pikë



Bashkëlidhur këtij Raporti gjendet kopje e vendimit nr. 153 datë 23.12.2019 “Për miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve të lejuar për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019 dhe rishpallur për plotësimin e kandidaturave në datën 09.09.2019”.

Gjithashtu, nëse do të vlerësohet nga organi i emërtesës, KED do të vendosë në dispozicion të tij, edhe kopje të plotë a të pjesshme të dokumentacionit të administruar dhe të shqyrtuar që përmban dosja e kandidimit të secilit kandidat të lejuar për kandidim dhe të vlerësuar, pikëzuar e renditur nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Ky Raport është shqyrtuar dhe miratuar me vendimin nr. 154, datë 23.12.2019 “Për miratimin e Raportit për Renditjen e Kandidatëve të Lejuar për Plotësimin e Vendit Vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019 dhe rishpallur për plotësimin e kandidaturave në datën 09.09.2019”.

KRYETARI

Ardian DVORANI

